

# KARTA E TË Drejtave

**MTA's preK-12 Profesionistët e Mbështetjes së Arsimit (Education Support Professionals - ESP) luajnë role të rëndësishme në shkollat tona publike, duke ofruar udhëzime individuale dhe në grupe të vogla për nxënësit me aftësi të kufizuara, duke ndihmuar klasat e arsimit të hershëm, duke mbështetur nxënësit e Gjuhës Angleze, duke vozitur autobusë, duke përgatitur ushqim, duke i mbajtur shkollat të pastra dhe duke kryer funksione të panumërta mbështetëse administrative dhe arsimore.**

**Një Pagë Jetese.** Të gjithë profesionistët e mbështetjes arsimore duhet të paguhet me një pagë të denjë. Asnjë punë nuk duhet të kërkojë më shumë se shtatë vjet për të arritur në hapin më të lartë.

**Sigurim Shëndetësor i Përbalueshëm.** Asnjë ESP nuk duhet të përfundojë me "çekun zero-dollar" të frikshëm për të përballuar primet e sigurimit shëndetësor. Të gjitha çeket për ESP-të duhet të pasqyrojnë të paktën pagën minimale shtetërore për orët e punës. Distrikti duhet të llogarisë çdo ndryshim midis shumës aktuale të çekut pas asaj që ka marr sigurimi dhe asaj që do të kishte marrë ESP në pagën minimale shtetërore në sektorin privat.

**Shëndeti dhe Siguria.** ESP-të vazhdojnë të jenë viktime të abuzimit fizik, verbal dhe emocional dhe bullizmit në vendin e punës. Për të ofruar një mjedis më të sigurt në shkollat tona, ESP-të kanë nevojë për furnizime adekuate, programe me staf të plotë, protokolle të qarta, trajnime të ofruara nga punëdhënësi mbi rregullat e OSHA-së dhe mbrojtje të sinjalizuesve.

**Pushimi Familjar dhe Mjekësor me Pagesë.** Jashtu si të gjithë banorët e Massachusetts, ESP-të meritojnë qasje në përfitimet e Pushimit Familjar dhe Mjekësor me Pagesë, si dhe qasje në mbrojtje të tjera PFMP, pavarësisht sa orë në javë punojnë.

**Siguria e Punës.** Shumë ESP nuk e dinë nëse do të kenë një punë nga një vit në tjetrin. Distriktet shkollore duhet ta eliminojnë këtë pasiguri dhe të angazhohen për rëndësinë e ESP-ve. ESP-të kanë nevojë për gjuhë të rinovimit automatik, një periudhë prove 90-ditore dhe dispozitat e forta justifikuese.

**Njohja si Edukatorë.** ESP-të meritojnë një zë të fortë në shkollat e tyre, burime për të pasur qasje në trajnime jashtë distriktit, mundësi zhvillimi profesional përkatëse dhe domethënëse dhe një rol në çdo komitet punonjës në çdo distrikt.

**Edukimi i Përbalueshëm për Forcimin e Karrierës.** Shumica dërrmuese e ESP-ve fitojnë më pak se 30,000 \$ në vit, pavarësisht nga fakti se gati 80 përqind kanë diploma kolegji. Shumë ESP mbajnë shuma të konsiderueshme të borxhit studentor ose po ndihmojnë anëtarët e familjes të paguajnë borxhin studentor. Shumë ESP duan më shumë arsimim, por nuk kanë mundësi të paguajnë për të. ESP-të meritojnë një mënyrë të përbalueshme për të ngjitur shkallët e karrierës arsimore - si dhe një mënyrë për të shlyer borxhin që lidhet me karrierën.

# KARTA E TË Drejtave

## Kalkulatori i Pagës së Jetesës

Shumat vjetore u përcaktuan duke përdorur Kalkulatorin e Pagës së Jetesës dhe bazohen në pagën e jetesës për një person të vetëm. Numrat pasqyrojnë pagën më të ulët që duhet të ketë një ESP dhe që duhet të përdoret për të ndihmuar në zhvillimin e tarifave fillestare në kontratat MTA.

Burimi: [livingwage.mit.edu](http://livingwage.mit.edu)

### Për nga Qarku

Qarku	Paga
Barnstable	\$55,099
Berkshire	\$45,415
Bristol	\$49,051
Dukes	\$59,627
Essex	\$56,040
Franklin	\$46,332
Hampden	\$43,087
Hampshire	\$47,681
Middlesex	\$64,870
Nantucket	\$65,278
Norfolk	\$69,396
Plymouth	\$58,382
Suffolk	\$65,877
Worcester	\$49,591

### Për nga Qyteti

Qyteli	Paga
Boston/ Cambridge/ Newton	\$62,487
Pittsfield	\$45,415
Springfield	\$44,493
Worcester	\$49,608
Barnstable Town	\$55,099

**Këto janë pagesat vjetore.** Për të gjetur pagesën tuaj për orë, pjesëtoni pagesën vjetore me numrin e ditëve për të cilat paguhet një ESP me orar të plotë dhe më pas pjesëtoni përsëri me numrin e orëve që punon një ESP me orar të plotë në ditë.

Shkoni në [www.massteacher.org/esp](http://www.massteacher.org/esp) ose kontaktoni [MTAESP@massteacher.org](mailto:MTAESP@massteacher.org) për më shumë informacion.